



Grupi i Punës 2

Drejtësia, Liria dhe Siguria

Institucionet

Pjesëmarrëse


Në Grupin e dytë të punës morrën pjesë 16 institucione dhe 107 pjesëmarrës.

4 sesione u zhvilluan në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme që është dhe institucioni përgjegjës për negociatat e kapitullit 24.

Kapitulli 24

Fushat e mbuluara përfshijnë harmonizimin e së drejtës private ndërkombëtare, marrëveshjet e ekstradimit ndërmjet shteteve anëtare, politikat e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të kufirit, vizave, emigracioni dhe politikat e azilit dhe bashkëpunim policor dhe gjyqësor.

Universitete
31.3%



Periudha e zhvillimit të sesioneve

Shkurt 2020 - Korrik 2021

Rekomandimet:



- Më rëndësi është koordinimi dhe qartësimi i detyrave dhe përgjegjësi të institucioneve dhe agjencive të tjera kombëtare, por edhe aktorëve jo-shtetërorë. Duke qenë që kapitulli 24 përfshin shumë fusha, që janë dhe të lidhura më njëra-tjetrën, është i nevojshëm kjo ndarje dhe koordinim, me anë të komunikimit, transparencës dhe informimit të vazhdueshëm në mënyrë menaxhimin e duhur.
- Këshillohet bashkëpunimi i ngushtë me organizata ndërkombëtare dhe OJF kombëtare, për shpërndarjen e informacionit dhe ndërgjegjësimin, ofrimin e shërbimeve të ndryshme dhe realizimin e atyre përgjegjësi që nuk mbulojnë dot nga institucionet shtetërore. Një bashkëpunim i ngushtë duhet dhe me organizmat dhe agjencitë e BE-së, si Frontex apo Eurojust, por edhe me shtetet anëtare.
- Përpjekjet duhet të vazhdojnë për harmonizimin e plotë të legjislacionit kombëtar me Acquis e BE-s. Kuadri ligjor për kapitullin 24 në Shqipëri është pjesërisht i harmonizuar me atë të BE-së, ku ndër të tjera në disa fusha ligjet mungojnë siç janë ato për krimet e urrejtjes apo krimet e kultit, dedektivët privatë etj.